AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# KOMUNIKATË PËR MEDIA

## Statistikat e Mirëqenies Sociale, Shkurt 2024

25.03.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin shkurt 2024.

## Rritet skema për përkrahje financiare familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara në shkurt 2024, krahasuar me shkurt 2023

Në muajin shkurt 2024, nga skema për përkrahje financiare familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 3 463, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, që ishte 2 869 përfitues, vërehet një rritje prej 20,7%.

**Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale**

| Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale | Muaji/Viti | | 2.2024/ |
|---|---|---|---|
| | 02.2023 | 02.2024 | 02.2023 |
| Skema e ndihmës sociale | 22 376 | 20 098 | -10,2 |
| Pensionet bazike të moshës | 138 446 | 148 230 | 7,1 |
| Pensionet kontributpaguese të moshës | 46 530 | 48 622 | 4,5 |
| Pensionet e personave me aftësi të kufizuara | 17 974 | 20 029 | 11,4 |
| Pensionet e Trepçës | 1 654 | 1 358 | -17,9 |
| Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës | 710 | 782 | 10,1 |
| Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës | 1 285 | 1 328 | 3,3 |
| Skema e të verbërve | 1 725 | 1 859 | 7,8 |
| Pensionet Familjare | 3 196 | 2 966 | -7,2 |
| Pensionet e Invalidëve të punës | 58 | 47 | -19,0 |
| Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike | 2 562 | 2 986 | 16,5 |
| Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99 | 12 951 | 13 688 | 5,7 |
| Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës | 13 048 | 12 859 | -1,4 |
| Veteranët | 36 821 | 36 950 | 0,4 |
| Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara | 2 869 | 3 463 | 20,7 |

### Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin shkurt 2024, krahasuar me muajin shkurt 2023, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-19,0%); skema për pensionet e Trepçës (-17,9%); skema e

ndihmës sociale (-10,2%) skema për pensionet familjare (-7,2%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,4%).

**Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë**

Në muajin shkurt 2024, krahasuar me muajin shkurt 2023, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: Pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike (16,5%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (11,4%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (10,1%); skema e kompensimeve për personat e verbër (7,8%); skema e pensioneve bazike të moshës (7,1%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,7%); skema e pensioneve kontribut - paguese të moshës (4,5%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,3%); skema për veteranët e luftës (0,4%).